


Albanese

SHKOLLA NË TRENTINO

UDHËZUES INFORMATIV PËR PRINDËRIT



Provincia autonoma di Trento

Assessorato all'istruzione
e politiche giovanili



giugno 2006
didascalie **QUADERNI**

Provincia autonoma di Trento
Assessorato all'Istruzione e alle Politiche giovanili
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione del sistema scolastico e formativo

"Millevoci" Centro Laboratorio Interculturale

Disegni di Iori Fabrizio dell'Istituto d'Arte Alessandro Vittoria – Trento

Stampa: Centro duplicazioni della PAT – giugno 2006

La presente pubblicazione è consultabile e scaricabile sul portale della scuola trentina:
www.vivoscuola.it

MIRËSERDHËT NË SHKOLLË

1. NË ÇFARË MOSHE SHKOHET NË SHKOLLË
2. ÇERDHJA
3. KOPËSHTI

4. CIKLI I PARË MËSIMOR
 - 4.1 SHKOLLA PRIMARE DHE SEKONDARE E SHKALLËS SË PARË (FILLORE DHE TETËVJEÇARE)
 - 4.2 SA KOHË ZGJAT SHKOLLA
 - 4.3 REGJISTRIMI
 - 4.4 MENSA E SHKOLLËS
 - 4.5 ZGJEDHJA E NJË LËNDE TJETËR NË VEND TË MËSIMIT TË FESË KATOLIKE
 - 4.6 TRANSPORTI SHKOLLOR
 - 4.7 FËMIJË/TË RINJ QË GJENDEN NË VËSHTIRËSI
 - 4.8 LËNDËT MËSIMORE TË SHKOLLËS
 - 4.9 PËR TË MËSUAR ITALISHTEN
 - 4.10 NDËRMJETËSIMI NDËRKULTUROR
 - 4.11 REZULTATET SHKOLLORE
 - 4.12 UDHËTIMET PËR QËLLIM MËSIMI
 - 4.13 MUNGESAT
 - 4.14 TAKIMET ME MËSUESIT

5. FJALËT E SHKOLLËS

6. PËR TË DITUR MË SHUMË

MIRËSERDHËT NË SHKOLLË

Përpara së gjithash po ju themi

“MIRËSERDHËT NË SHKOLLË”.

Shkolla primare (fillore) në Itali është një e drejtë dhe një detyrë e të gjithë fëmijëve (djem e vajza) dhe nuk ka rëndësi prejardhja dhe gjuha që flasim.

Në çdo periudhë të vitit, në momentin që arrin në Itali, çdo fëmijë (vajzë apo djalë) ka të drejtë/detyrë të regjistrohet në shkollë.

Për këtë arsye shkolla është pa pagesë, për t'i garantuar të gjithëve mundësinë për ta frekuentuar.

Shkolla është një vend mësimi, bashkëjetese dhe respekti reciprok ku kulturat e ndryshme kanë të njëjtën vlerë dhe dinjitet.

Me këtë libërth kemi dëshirë t'i japim prindërve informacionet kryesore për shkollën në Trentino, duke e ftuar vetë shkollën që të jetë gjithmonë një vend ku dijet, kulturat dhe traditat e botës pasurojnë njëra-tjetrën, bashkëjetojnë dhe vlerësohen reciprokisht.

1. NË ÇFARË MOSHE SHKOHET NË SHKOLLË

PËRPARA MOSHËS GJASHTË VJEÇ

a. ÇERDHJA

Deri në 3 vjeç

b. KOPËSHTI

Nga 3 deri në 6 vjeç

CIKLI I PARË MËSIMOR

- Shkolla primare
(Shkolla Elementare)

Nga 6 deri në 11 vjeç

- Shkolla sekondare
e shkallës së parë
(Shkolla Tetëvjeçare)

Nga 11 deri në 14 vjeç

CIKLI I DYTË MËSIMOR

- (Shkolla Sekondare Superiore - Shkolla e Mesme)
- Shkollat sekondare
të shkallës së dytë
(Lice dhe Institute Teknike)

Nga 14 deri në 19 vjeç

Ose

- Shkollat e Formimit
Profesional

Nga 14 vjeç
dhe deri në 18 vjeç

2. ÇERDHJA

Çerdhja i pranon fëmijët (femra dhe meshkuj) me moshë që përfshihet ndërmjet 3 muajsh dhe 3 vjeç.

Frekuentimi i çerdhes nuk është i detyrueshëm.

Në komunat, ku jepet ky shërbim, ka një listë klasifikuese që përfshin pyetjet e bëra nga familjet për regjistrimin e fëmijëve të tyre.


Kostoja mujore ndryshon sipas të ardhurave familjare.

Fëmijët mund të qëndrojnë në çerdhe gjatë gjithë ditës ose vetëm për një gjysëm dite.

Ka shërbim mense.

Në çdo çerdhe gjenden edukatorët që punojnë me ndihmën e një bashkërenditësi pedagogjik (mësues).

Për pjesëmarrjen e prindërve në planin mësimor të shërbimit në çerdhe zhvillohen aktivitete, si: mbledhje të përgjithshme, takime në seksion, takime individuale, festa, shëtitje...



3. KOPËSHTI

Kopështi zgjat tre vjet dhe nuk është i detyrueshëm.


Fillon me 1 shtator dhe mbaron me 30 qershor.

Zakonisht fëmijët (djem/vajza) mund të regjistrohen në qoftë se kanë mbushur 3 vjeç brenda janarit, por prindërit mundën, duke bërë lutje, të bëjnë regjistrimin e tyre të parakohshëm që nga mosha dy vjeç e gjysëm.

Është e rëndësishme të dijmë se:

- integrimi në jetën shkollore bëhet në mënyrë të shkallëzuar.
- lutja për regjistrim duhet të plotësohet nga prindërit nëpërmjet formularëve të duhur.
- çerdhja është e hapur pesë ditë në javë dhe për shtatë orë në ditë;
- për prindërit që punojnë më shumë se shtatë orët normale të shkollës ka një shërbim për pritje përpara orarit të fillimit të mësimit dhe pas orarit të mbarimit të mësimit, deri në një maksimum prej 3 orësh. Prindërit që shfrytëzojnë shërbimin e zgjatjes së orarit e bëjnë kërkesën në momentin e regjistrimit dhe duhet të paguajnë një kuotë shtesë;
- kopështi është i organizuar në grupe dhe çdo grup ka dy edukatorë;
- me anën e kontributit ekonomik të familjeve sigurohet shërbimi i mensës;
- fëmijët që kanë probleme invaliditeti integrohen në shkollë me anën edukatorëve ndihmës.

PËR INFORMACIONE DREJTOHUNI NË KOPËSHTIN E KOMUNËS
OSE TË LAGJES SUAJ



4. CIKLI I PARË MËSIMOR

4.1 SHKOLLA PRIMARE DHE SEKONDARE E SHKALLËS SË PARË (FILLORE DHE TETËVJEÇARE)

Në shkollën fillore mund të regjistrohen fëmijët (djem/vajza) që mbushin 6 vjeç brenda fundit të shkurtit të vitit të ardhshëm. Shkolla zgjat 5 vjet, është e ndarë në klasa, për çdo klasë ka 3 ose 4 mësues/e dhe secili/a prej tyre mund të japë mësim në lëndë të ndryshme.

Në moshën 11 vjeç fillon shkolla tetëvjeçare e cila zgjat 3 vjet. Edhe shkolla tetëvjeçare është e ndarë në klasa, në çdo klasë secili nga profesorët dhe profesoreshat jep mësim në një lëndë të veçantë.

Kalohet nga shkolla fillore në tetëvjeçare nëpërmjet një vlerësimi pozitiv në fund të klasës së pestë fillore, ndërsa në klasën e tetë (terza media) ka një provim shteti.

Shkolla është pa pagesë. Librat e shkollave fillore jepen nga shkolla, ndërsa në shkollën tetëvjeçare librat jepen borxh. Familjet duhet të blejnë fletoret, penat dhe bojërat.



4.2 SA KOHË ZGJAT SHKOLLA

Shkolla fillon nga gjysma e shtatorit dhe mbaron nga gjysma e qershorit.

Çdo shkollë ka orarin e vet javor i cili mund të ndahet në 5 ditë (nga e hëna deri të premten) ose në 6 ditë (nga e hëna deri të shtunën) me disa pasdreke që mund të ndryshojnë nga shkolla në shkollë.

Disa orë janë fakultative, pra nuk janë të detyrueshme dhe prindërit mund të vendosin se cilat aktivitete duhen zgjedhur për të regjistruar fëmijët.

Gjatë vitit ka dy periudha të gjata pushimesh:

- dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga 23 dhjetori deri në 7 janar).
- rreth një javë për Pashkë (në mars ose në prill).

4.3 REGJISTRIMI

Në muajin janar bëhen regjistrimet si për shkollat fillore ashtu edhe për tetëvjeçarët.

Fëmijët që arrijnë në Itali, kur viti shkollor ka filluar, kanë të drejtë të regjistrohen në çdo periudhë të vitit, pavarësisht se janë në rregull me lejen e qëndrimit apo jo.

- Në momentin e regjistrimit duhen dokumentat e mëposhtëm:
 - a) Dokumenti i identitetit (pasaporta, çertifikata e lindjes) vetë-çertifikata e shkruar nga prindi ose nga personi që është kujdestar për fëmijën.
 - b) Çertifikatat e studimeve që janë bërë në vendlindje ose deklarata e prindit të nxënësit ose e personit që ka në kujdestari të miturin, e cila vërteton klasën e mbaruar dhe tipin e Shkollës që është frekuentuar.
 - c) Çertifikatat në lidhje me vaksinimet e detyrueshme:
 - Kundra poliomielitit
 - Kundra diftetetanozit
 - Kundra hepatitit viral BNxënësit dhe nxënëset që nuk i kanë çertifikatat duhet me çdo kusht të regjistrohen në shkollë, por prindërit duhet të paraqiten me fëmijën në Ndërmarrjen Sanitare tek Zyra e vaksinimeve (Azienda Sanitaria - Ufficio Vaccinazioni) për një kontroll të vaksinimeve të bëra dhe të atyre që duhen bërë.
- Në momentin e regjistrimit plotësohen formularët përkatës për:
 - a) Zgjedhjen e tipit të orarit shkollor;
 - b) Regjistrimit në mensën e shkollës;
 - c) Mundësisë për zgjedhur mësimin e besimit katolik.



4.4 MENSA E SHKOLLËS

Pothuajse në të gjitha shkollat, kur ka mësim gjatë pasdrekës, organizohet një shërbim i mensës shkollore. Për t'u regjistruar duhet të plotësohet një formular i parastampuar i cili i dorëzohet sekretarisë së shkollës në momentin e regjistrimit. Nuk është e detyrueshme të regjistrohemi në mensën e shkollës dhe është e mundur të kërkohet një dietë e veçantë për arsye shëndetësore ose për arsye fetare.

Për kërkesa të mundshme dhe lehtësime në lidhje me kuotën e mensës, drejtohuni te Shërbimet Sociale (Servizi Sociali) kompetente ose te Shërbimi Arsimor i Zonës (Servizio Istruzione dei Comprensori).

Është mirë gjithmonë që të kërkohen informacione te sekretaria e shkollës.


4.5 ZGJEDHJA E NJË LËNDE TJETËR NË VEND TË MËSIMIT TË FESË KATOLIKE

Për 2 orë në javë në shkollën fillore dhe 1 në shkollën sekondare parashikohet mësimi i fesë katolike.

Në momentin e regjistrimit janë prindërit ata që duhet të zgjedhin, duke plotësuar formularin përkatës, nëse fëmija i tyre duhet të frekuentojë mësimet e fesë katolike.

Në vend të orëve për mësimin e fesë prindërit mund të zgjedhin aktivitetet e mëposhtme:

1. aktivitete mësimore dhe formuese,
2. aktivitete studimi dhe/ose kërkimore individuale me ndihmën e personelit mësimdhënës,
3. aktivitete të lira studimi dhe/ose kërkimore pa ndihmën e personelit mësimdhënës.



4.6 TRANSPORTI SHKOLLOR

Në qoftë se banojmë më shumë se 1 Km larg nga shkolla, mund të shfrytëzojmë një shërbim transporti shkollor. Për këtë është e këshillueshme të pyesim gjithmonë në sekretarinë e shkollës për të gjitha informacionet e nevojshme.


4.7 FËMIJË/TË RINJ QË GJENDEN NË VËSHTIRËSI

Në Itali ligji parashikon që të gjithë fëmijët mund të frekuentojnë shkollën, pavarësisht nga prania e paaftësive fizike ose psikike. Do të jetë shkolla ajo që do të organizojë, nëpërmjet personelit ndihmës ose edukatorëve, rrugët e veçanta për ndjekjen e mësimin dhe lehtësimet e nevojshme. Me qëllim që të ketë mundësi të organizojë sa më mirë futjen në mësim të fëmijëve këshillohet që të lajmërohet shkolla, për situatën, përpara fillimit të vitit shkollor.

4.8 LËNDËT MËSIMORE TË SHKOLLËS

Në Ciklin e Parë Mësimor studiohet:

SHKOLLA ELEMENTARE	SHKOLLA TETËVJEÇARE
1. italisht	1. italisht
2. gjermanisht ose anglisht	2. gjermanisht
3. anglisht ose gjermanisht (mësohet në të tretën, duke u bazuar në disponueshmërinë e çdo shkolle)	4. anglisht (në disa shkolla frëngjisht)
4. histori	5. histori
5. gjeografi	6. gjeografi
6. matematikë	7. matematikë
7. shkenca	8. shkenca
8. teknologji dhe informatikë	9. teknologji
9. muzikë	10. informatikë
10. art dhe vizatim	11. muzikë
11. shkencat e lëvizjes dhe sportive	12. art dhe vizatim
12. aktivitete fakultative	13. shkencat e lëvizjes dhe sportive
	14. aktivitete fakultative



4.9 PËR TË MËSUAR ITALISHTEN

Njohja e mirë e gjuhës italiane është kryesore për suksesin shkollor të nxënësve. Për këtë arsye shkollat organizojnë, për ata që kanë nevojë, variante të veçanta për mësimin vetjak të italishtes për të komunikuar dhe për perfeksionuar përdorimin e gjuhës në lëndët e veçanta shkollore.

Çdo shkollë ka sistemet e veta të cilat marrin parasysh diferencat e aftësive komunikuese fillestare. Për këtë, mësuesit në klasë, programojnë ndërhyrje të veçanta të përcaktuara për çdo individ. Për informacione më të hollësishme drejtohuni te mësuesit e klasës.

4.10 NDËRMJETËSIMI NDËRKULTUROR

Shkolla mund të kërkojë bashkëpunimin e një ndërmjetësi ndërkulturor (mediatore interculturale) dhe të përcaktojë një projekt i cili mund të ketë të bëjë me këto sektorë:

- a) të lehtësojë komunikimin ndërmjet shkollës dhe familjes, kur është nevoja;
- b) të lejojë ballafaqimin me sistemin shkollor të vendit të prejardhjes dhe të sistemit shkollor italian;
- c) të favorizojë përcaktimin e aftësive shkollore të nxënësit sipas gjuhës së vendit të prejardhjes;
- d) të favorizojë një klimë ndërkulturore në klasën ku është futur nxënësi;
- e) të realizojë një program fuqizimi, përforcimi dhe mësimi të gjuhës amtare.

4.11 REZULTATET SHKOLLORE

Çdo vit shkollor është i ndarë në periudha që mund të jenë katërmujore ose trimestra. Në fund të çdo periudhe bëhet një vlerësim i mësuesve në lidhje me rezultatet shkollore që janë arritur nga fëmija. Familjes do t'i dorëzohet një "dokument vlerësimi - dëftesë" (documento di valutazione).

Në dokumentin e vlerësimit (SKEDA PERSONALE ose DËFTESA SHKOLLORE), e cila vlen si çertifikatë, regjistrohen vlerësimet në lidhje me lëndët e ndryshme dhe një vlerësim i përgjithshëm për shkallën e pjekurisë dhe për sjelljen. Shkalla e vlerësimit është kjo:

- jo majftueshëm
- majftueshëm
- mirë
- shumë mirë
- shkëlqyeshëm



Provimi i shtetit që zhvillohet në klasën e tetë (terza media) parashikon si lëndë provimi të gjitha disiplinat e studiuara gjatë po atij viti shkollor.

Parashikohen këto provime:

- provim me shkrim i italishtes;
- provim me shkrim për çdo gjuhë të huaj të studiuar;
- provim me shkrim në matematikë;
- kolokium me gojë ndërdisiplinor për disiplinat (lëndët) që janë studiuar.

4.12 UDHËTIMET PËR QËLLIM MËSIMI

Çdo vit, shkollat organizojnë të paktën një udhëtim mësimor me klasat, me qëllim që të pasurojnë propozimet formuese me një përvojë direkte të njohjes.

Destinacionet e zgjedhura mund të jenë nga më të ndryshmet, mund të kenë të bëjnë me vendet arkeologjike, ambientet natyrore, arkitekturën, artin dhe artizanatin.

Udhëtimet mësimore kanë një kohëzgjatje të ndryshme sipas destinacionit që është zgjedhur. Nuk është e detyrueshme t'i dërgojmë fëmijët në udhëtim, por është shumë e këshillueshme.

Zakonisht familjes i kërkohet një kontribut ekonomik që mund të reduktohet ose anulohet në rast nevojë, duke i bërë kërkesën e duhur mësuesve dhe/ose sekretarisë shkollore.

4.13 MUNGESAT

Çdo mungesë nga shkolla duhet të jetë gjithmonë e justifikuar nga prindërit. Edhe atëherë kur nxënësi hyn në shkollë me vonesë ose duhet të dalë para kohe, duhet të paraqesë një justifikim ose një kërkesë të firmosur nga prindërit.

4.14 TAKIMET ME MËSUESIT

Mësuesit, zakonisht në periudhën e parë të vitit shkollor (tetor), i thërrasin prindërit e klasës në një mbledhje për të folur me to për programin e klasës, për fëmijët dhe për vështirësitë dhe përparimet e tyre në shkollë. Në këtë rast prindërit zgjedhin përfaqësuesit e tyre të klasës.

Këto momente takimi janë shumë të rëndësishme sepse shkolla dhe familja mund të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke për edukimin e famijëve.

Takimet individuale janë momente takimi dhe shkëmbimi të informacioneve ndërmjet mësuesve dhe prindërve. Çdo mësues i komunikon prindërve ditën në të cilën ai mund t'i takojë për të folur për fëmijët. Edhe prindërit mund të kërkojnë një kolokium (takim) me mësuesit.

5. FJALËT E SHKOLLËS

1. **Ammissione/Non-ammissione (Pranim/Mos-pranim):** pranimi (kalimi i klasës) sjell kalimin në vitin tjetër shkollor, mos-pranimi (mbetja) sjell përsëritjen e vitit shkollor, kur nuk janë arritur objektivat minimal.
2. **Attività facoltative (Aktivitetet fakultative):** aktivitetet edukuese të zgjedhura nga çdo shkollë si propozim për edukimin. Nuk janë të detyrueshme.
3. **Bidello/a (Kujdestari (roja) i shkollës):** garanton që shkolla të jetë e mbrojtur, në rregull dhe funksionuese.
4. **Collegio docenti (Kolegji i docentëve):** të gjithë mësuesit e një instituti shkollor.
5. **Curricolo/curricolare (Kurrikolo/kurrikolar):** është programmi për çdo disiplinë.
6. **Dirigente scolastico (Drejtor shkollë):** është përgjegjësi/ja i/e shkollës.
7. **Discipline (Disiplinat):** janë lëndët që studiohen në shkollë
8. **Insegnanti o docenti (Mësues ose docenta):** mësuesit/et dhe profesorat/profesoreshat, përkatësisht për shkollën primare dhe sekondare të shkollës së parë dhe të dytë (elementare dhe tetëvjeçare).
9. **Iscrizione (Regjistrimi):** çdo nxënës regjistrohet në shkollën që ka ndërmend të frekuentojë. Regjistrimi bëhet në Sekretari.
10. **Istituto Comprensivo Scolastico (Instituti i Përbashkët Shkollor):** përfshin disa shkolla që varen nga i/e njëjti/a drejtues/e.
11. **Mensa (Mensa):** të jep mundësi të hash drekë në shkollë kur ka mësim gjatë pasdrekes.
12. **Moduli (Formularë):** janë modele të para-stampuara që duhet të plotësohen dhe firmosen.
13. **Personale di segretaria (Personeli i sekretarisë):** janë nëpunës/e me detyra të veçanta sekretarie ose organizimi shkollor.
14. **Quadrimestre (Katërmujori):** janë 2 në çdo vit shkollor. Në fund të çdo katërmujori bëhet vlerësimi.
15. **Rappresentante de classe (Përfaqësuesi i klasës):** është përfaqësuesi i prindërve në klasë, zgjidhet në fillim të çdo viti shkollor.
16. **Ricreazione (Pushimi):** është pauza gjatë gjysmës së mëngjesit për t'u zbavitur pak dhe për të ngrënë diçka të vogël.
17. **Segretaria Scolastica (Sekretaria Shkollore):** është vendi në të cilin bëhen regjistrimet në shkollë. Aty mund të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për shkollën dhe shërbimet e saj.
Kontrolloni oraret dhe ditët e hapjes së Sekretarisë së Shkollës.
18. **Scheda di valutazione (Skeda e vlerësimit):** përmban vlerësimet e katërmujorit dhe të fundit të vitit shkollor në lidhje me përparimet mësimore.
19. **Trimestre (Trimestri):** janë 3 në çdo vit shkollor. Në fund të çdo trimestri bëhet vlerësimi (në vend të katërmujorit).
20. **Valutazione (Vlerësimi):** është gjykimi për mësimet, si të disiplinave ashtu edhe të pjekurisë personale. Skeda e vlerësimit i tregohet familjeve dhe firmoset nga ato në fund të çdo katërmujori (trimestri), ndërsa i dorëzohet dhe i lihet familjes në fund të vitit shkollor.

6. PËR TË DITUR MË SHUMË

Për të kërkuar informacione mund t'i drejtoheni:

1. Centro Interculturale Millevoci (Qendra Ndërkulturore Njëmijëzëra)
Via S. Pio X, 103
38100 Trento
Tel. 0461 920955
Fax. 0461 930529
E-mail: millevoci@provincia.tn.it
www.vivoscuola.it/intercultura/

Inserire i dati della scuola:

--